

MANUALI I PËRDORIMIT TË SMARTPAY-TRANSFER PARASH ME QR



SmartPay

© Të drejtat e autorit BKT 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, përkthehet, përshtatet, rregullohet, ose të ndryshohet në çdo lloj mënyre, të shpërndahet, komunikohet, huazohet, ruhet në sisteme të dhënash, apo të transmetohet në çdo formë a mënyrë, elektronike, mekanike, të fotokopjohet, regjistrohet apo të shfaqet për publikun, apo të jetë objekt i çdo veprimi apo aktiviteti që ligji e mbron në favor të zotëruesit të të drejtës së autorit, pa lejen paraprake me shkrim nga BKT.

1. HYRJE

QR SmartPay

Shërbimi SmartPay është shërbim në aplikacionin BKT Mobile që ofron një formë/mënyrë të transferimit të parave duke përdorur funksionalitetin e Kodit QR. Ky veprim mund të arrihet/qaset jashtë menisë së aplikacionit BKT Mobile duke klikuar ikonën SmartPay që do të shfaqet në faqen e Para-Hyrjes në BKT Mobile.

Ky shërbim mundëson transferimin e fondeve brenda llogarive individuale në BKT, lehtë dhe më shpejt duke përdorur Kodin QR.

Për tu kyçur në Mobile Banking duhet instaluar aplikacioni nën emrin BKT Mobile në smartphone apo tablet, i cili mund të gjendet në App Store dhe Play Store.

Beneficionet:

Pagesat e menjëhershme

Një nga avantazhet më të mëdha të përdorimit të kodeve QR është se, mundëson pagesën e menjëhershme. Kryerja e pagesave përmes kodeve QR është jashtëzakonisht e shpejt në krahasim me mënyrat e tjera të pagesës. E vetmja gjë që një përdorues duhet të bëjë është thjesht të hapë aplikacionin e skanimit të kodit QR, të skanojë kodin QR dhe të konfirmojë për të përfunduar pagesën. Pagesa realizohet brenda disa sekondave në llogari.

Siguri e shkallës së lartë

Bërja e pagesave përmes kodeve QR është shumë e sigurt. Kodi QR përdoret për të shkëmbyer informacione të sakta dhe në mënyrë të sigurt. Çdo e dhënë që transferohet përmes kodeve QR është e enkriptuar, duke e bërë të sigurt pagesën.

E lehtë për t'u konfiguruar

Vendosja e mënyrës së pagesave përmes kodit QR është e lehtë, sepse nuk ka nevojë për shumë infrastrukturë. Pagesa bëhet përmes smartphone dhe aplikacionit BKT Mobile, dhe një kod QR i cili është i shtypur ose në formë elektronike. Përdorimi i kodeve QR për pagesa gjithashtu eliminon kërkesën për çdo pajisje tjetër që përdoret për të kryer pagesa.

Besueshmëri më e lartë

Veprimet me kod QR janë një mënyrë pagese me konfirmim të plotë pasi eliminon mundësinë e çdo lloji gabimi. Kodi QR përbëhet nga të dhëna unike që rrit besueshmërinë e veprimeve me kodin QR.

Shënim

Shërbimi QR ofrohet për klientët e BKT-së në platformën BKT Mobile IOS dhe Android për transferim parash mes llogarive individuale të BKT-së

2. Kushtet dhe Parametrat e modulit SmartPay

	Kushtet dhe parametrat
Tipi	SmartPay mund të gjendet tek faqja e Para-Identifikimit në aplikacionin BKT Mobile. Ky shërbim shërben për të gjeneruar një kërkesë për transferim parash me QR Kod apo për t'i pranuar, brenda llogarive individuale të BKT -së.
Valuta për transfer	Të gjitha valutat të cilat ofrohen nga banka
Siguria	Për qasje në SmartPay do të dërgohet SMS me FNP nga banka
Komisioni për instalim	Pa pagesë për klientët individual
Komisioni për transaksion	Sipas çmimorës aktuale për veprime në e-banking
Limitet	TRANSFERET ME KYÇJE TË PJESËSHME (NUMRI I KLIENTIT + PASSWORDI) Vlera Max për transaksion - 100 EUR Vlera Max ditore - 100 EUR Nr i transaksioneve ditore - 3 trans. TRANSFERET ME KYÇJE TË PLOTË (NUMRI I KLIENTIT + PASSWORD + FNP) Vlera Max për transaksion - 8,000 EUR Vlera Max ditore - 16,000 EUR Nr. i transaksioneve ditore - pa limit
Parakushtet	- Dërguesi dhe pranuesi i transaksionit duhet të jenë klientë të BKT-së - Dërguesi dhe pranuesi i transaksionit duhet të kenë të instaluar aplikacionin BKT Mobile në pajisjen e tyre - Dërguesi dhe pranuesi duhet të hapin një QR llogari në platformën SmartPay - Niveli i sigurisë në pajisjen duhet të jetë "Aktiv" (identifikim me gjurmë të gishtërinjve, fjalëkalim, etj.)

3. Identifikimi/Kyçja

Për të filluar ekzekutimin e transaksioneve në modulën QR SmartPay duhet të bëhet verifikimi/kyçja përmes kredencialeve të BKT Mobile.

Në SmartPay mund të përcaktohen dy forma të kyçjes në përputhje me nivelin e sigurisë në pajisje **:

- Kyçje e Plotë: me CIF*, Fjalëkalim dhe FNP
- Kyçje e pjesshme/Kyçje me SmartFNP **: me CIF dhe Fjalëkalim

*CIF – është numri i klientit të cilin mund ta marrni nga banka për të u regjistruar në BKT Mobile.


** niveli i lartë i sigurisë i pajisjes është hapja e telefonit me Fjalëkalim apo Gjurmë të gishtit apo Pattern etj.

Pas kyçjes me identifikim të plotë tek profili mund të përzgjidhet mundësia që në mënyrë automatike të lejohet Kyçja e pjesshme/Kyçja me SmartFNP.

4.Regjistrimi në QR SmartPay


Për të filluar përdorimin e Shërbimit QR SmartPay, fillimisht duhet:

- të jeni klient i Bankës dhe përdorues i regjistruar në BKT Mobile,
- të keni të instaluar në pajisjen tuaj të mençur Aplikacionin BKT Mobile në versionin IOS apo Android,
- të bëhet regjistrimi dhe çasja në shërbimin SmartPay përmes identifikimit të plotë dhe pjesshëm-identifikimit duke verifikuar informatat tuaja personale si: Numri i klientit, Fjalëkalimi dhe FNP,
- të pranoni Termet dhe Kushtet për hapjen e llogarisë në SmartPay, e cila përdoret për këtë shërbim




Hapi i parë

Hapni dhe Shfletoni të gjithë përmbajtjen e cila shfaqet në ekran.
Shtypni butonin **Pranoj**



Hapi i dytë

Vendosni të dhënat për kyçje.
Shtypni butonin **Aprovo**



Hapi i tretë

Vendosni kodin katër shifror – FNP*
që do të dërgohet me SMS
Shtypni butonin **Aprovo**


4.1 Krijimi i llogarisë QR

Pasi që të bëhet regjistrimi në shërbimin QR SmartPay, duhet të hapet llogaria QR e cila do të mundësoj të pranimin/dërgimin e parave përmes këtij shërbimi. Në momentin e hapjes së llogarisë QR, aplikacioni SmartPay automatikisht do të krijoj kodin QR Dinamik i cilin mund të përdoret për të pranuar para. Për të dërguar një QR kod me vlerë të para definuar, duhet të specifikohet vlera dhe kodi QR i gjeneruar me vlerë të përcaktuar do të jetë i tipit QR Statik.




Hapi i parë

Për të hapur llogarinë QR SmartPay Klikoni butonin "Krijoni Llogari QR"



Hapi i dytë

Zgjidhni llogarinë e cila do të përdoret të pranoni/dërgoni para me QR



Hapi i tretë

Shtypni butonin **Aprovo** që të autorizoni hapjen e llogarisë



Hapi i katërt

Llogaria QR dhe Kodi QR Statik është krijuar dhe mund të pranoni/dërgoni para

4.2 Llogaritë e mia

Tek menu llogaritë e mia mund të shikoni të gjitha llogaritë QR të hapura:



Hapi i parë

Klikoni tek butoni "Llogaritë e mia"



Hapi i dytë

Në ekran mund të shihni llogaritë QR të cilat janë të hapura dhe në të gjitha valutat

Shënim

Ju mund të hapni më shumë se një llogari QR dhe në valuta të ndryshme, për të kryer veprime në këtë shërbim.

5. Llojet e QR Kodit

Kodi QR është kodi i gjeneruar nga pajisja pas regjistrimit dhe hapjes së llogarisë QR. Kodi QR në SmartPay ofrohet në dy mundësi të cilat mund të shfrytëzohen për pranim/dërgim të parave:

- ✓ Kodi QR Dinamik
- ✓ Kodi QR Statik

5.1 Kodi QR Dinamik



Kodi QR Dinamik nuk ka vlerë të paracaktuar dhe është valid deri sa të jetë e hapur llogaria QR.

Kodi QR Dinamik nuk ka vlerë të paracaktuar dhe është valid deri sa të jetë e hapur llogaria QR.

Për të pranuar transfer të parave me Kod QR dinamik, duhet të ndahet kodi QR me palët e treta në formë të fotografisë me anë të mesazheve ose të skanohet kodi direkt nga pajisja/telefoni.

Shuma e transferit përcaktohet nga dërguesi i mjeteve.

5.2 Kodi QR Statik


Kodi QR Statik është kodi i gjeneruar në aplikacionin SmartPay, ku duhet të përcaktohet vlera/shuma e transaksionit e cila kërkohet të pranohet nga pala tjetër. Kodi i gjeneruar mund të ndahet me palët e treta në formë të fotografisë me anë të mesazheve ose të skanohet kodi direkt nga pajisja/telefoni.

Çdo kod QR dinamik në momentin që gjenerohet nga përdoruesi, ka të para definuar në mënyrë automatike afatin e vlefshmërisë. Në rast se tentohet të ekzekutohet pas afatit të skadimit aplikacioni do të njoftojë se kodi QR nuk është valid dhe nuk mund të përdoret për të realizuar transaksionin.

QR statik i përdorur nuk mund të ripërdoret përsëri nga palët.



Hapi i parë
Klikoni butonin
Specifikoni Shumën



Hapi i dytë
Vendosni vlerën
Klikoni butonin **Aprovo**



Hapi i tretë
QR Kodi në ekran mund të skanohet
apo shpërndahet tek personi tjetër

6. Transaksionet me shërbimin QR SmartPay

Përmes shërbimit QR SmartPay mund të realizohen transaksione ndërmjet llogarive individuale brenda BKT-së.


Me këtë opsion dërguesi mund të lexojë imazhin statik apo dinamik të Kodit QR që gjenerohet nga pala tjetër nga aplikacioni i tij BKT Mobile. Leximi i kodit QR përmes aplikacionit mundësohet në dy mënyra:

- duke skanuar QR kodin direkt në pajisjen tjetër:




Hapi i parë

Klikoni butonin e kamerës



Hapi i dytë

Skenoni QR kodin nga pajisja tjetër



Hapi i tretë

Konfirmimi të dhënat
Klikoni **Përfundoni Pagesën**



Hapi i Katërt

Në ekranin e fundit pranoni konfirmimin se transferi u realizua me sukses

* Nëse keni pranuar kodin dinamik QR pasi që te keni skanuar do të iu kërkohet që te vendosni vlerën e transfertës për të përfunduar transferimin e mjeteve.


** Limiti i mbritërheqjes do të mund të përdoret nëse është i aprovuar më herët nga banka

b. apo duke zgjedhur imazhin e Kodit QR nga galeria e pajisjes:



Hapi i parë

Klikoni butonin e kamerës




Hapi i dytë

Zgjedhni opsionin **Skan nga Galeria** që të lexoni QR




Hapi i tretë

Zgjidhni QR kodin që keni pranuar nga pala tjetër në galerinë e telefonit




Hapi i katërt

Pasi të keni lexuar QR kodin dinamik, vendosni vlerën e transferit



Hapi i pestë

Pasi të keni lexuar QR Konfirmimi të dhënat dhe klikoni **Përfundoni Pagesën**



Hapi i gjashtë

Në ekranin e fundit pranoni konfirmim se transferi u realizua me sukses

7. Specifikat tjera të QR SmartPay


7.1 Anulimi i QR Kodit

Kodi QR dinamik i gjeneruar nga përdoruesi mund të anulohet në çdo kohë (përderisa është valid), dhe i cili nuk mund të shfrytëzohet tutje.




Hapi i parë

Tek menu kryesore, klikoni butonin **"Kërkesat"**




Hapi i dytë

Të gjitha kërkesat e hapura/ mbyllura/anuluara do të shfaqen. Për të vazhduar me anulim, duhet të zgjidhet kërkesa e hapur



Hapi i tretë

Shtypni butonin **Anulo QR** që të anuloni QR kodin



Hapi i Katërt

Pasi që të keni anuluar, QR do të shfaqet i hijezuar dhe anuluar.


7.2 Monitorimi i transaksioneve

Përdoruesi i QR SmartPay mund të monitoron të gjitha kërkesat e krijuara dhe hyrjet e pranuar nga personat e tjerë. Tek menu **kërkesat** mund të shihen informata e kërkesave dhe statuset e tyre: Hapur, Anuluar apo e Mbyllur.




Hapi i parë

Tek menu kryesore, klikoni butonin **"Hyrjet"** apo **"Kërkesat"**



Hapi i dytë

Tek **"Hyrjet"** do të ju shfaqen të gjitha pranimet të cilat i keni marr përmes QR



Hapi i tretë

Tek **"Kërkesat"** mund të shihni statuset dhe detajet e kërkesave të hapura


7.3 Anulimi i llogarisë QR

Llogaria QR e hapur gjatë procesit të regjistrimit apo më vonë, mund edhe të fshihet nga përdoruesi. Pas fshirjes, kjo llogari nuk mund të përdoret edhe nëse janë shpërndarë Kode QR tek personat tjerë, dhe nëse tentohet të realizohet ndonjë transaksion në këtë llogari, përdoruesi do të njoftohet se kjo llogari/tiketë nuk është Valide.




Hapi i parë

Klikoni tek butoni **i** tek emri dhe mbiemri juaj



Hapi i dytë

Zgjidhni llogarinë e cila duhet të fshihet, verifikoni informatat dhe klikoni butonin **"Fshij Llogarinë"**



Hapi i tretë

Shtypni butonin **Aprovo** që të autorizoni fshirjen e llogarisë



Hapi i Katërt

Pasi që të keni fshirë llogarinë QR, mund të hapni llogari tjetër përsëri

8. Profili i Përdoruesit

Kjo menu do të shfaqet në pjesën balllore të QR SmartPay, nga e cila mund të shihen informacionet për përdoruesin dhe funksionet më poshtme të shërbimit:

a. Dalja/Exit

Ky funksion do të dërgojë përdoruesin në faqen Para-Kyçjes në BKT Mobile përdoruesin, dhe në tentimin e ri-kyçjes, shërbimi QR SmartPay do të hapet automatikisht me vërtetim të pjesshëm.

b. Më harro/Forget Me

Ky funksion do të dërgojë përdoruesin në faqen e Para-Kyçjes në BKT Mobile dhe do të de-aktivizojë kyçjen me Vërtetimi i pjesshëm deri në kyçjen e radhës me Vërtetim të Plotë. Në tentimin e kyçjes, përdoruesit do të i kërkohet të i vendos të gjitha të dhënat: numri i klientit, fjalëkalimin dhe FNP.

c. Kyçja me Smart FNP

Në këtë funksion, përdoruesi mund të definojë nëse do të identifikohet përmes opsionit Smart FNP apo jo, apo çdo herë të kyçet me identifikim të Plotë.

Ky funksion është i para definuar "Po" dhe mund të ndryshohet në momentin e kyçjes me identifikim të plotë.

Për të lejuar kyçja me SmartFNP, është e domosdoshme që pajisja të ketë të lejuar masat e sigurisë (kyçja në pajisje me: Fjalëkalim, fingerprint, Face ID, Pattern etj.).

